REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
AGENCIJA ZA BESPLATNU PRAVNU POMOĆ
AGENCY FOR FREE LEGAL AID
Nr./Br./No. 20-01 Nr.f./Br.str./No.pg. 06
Data/Datum/Date 20.09.2022
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas/Agencia za Besplatnu Pravnu Pomoć
Agency for Free Legal Aid

KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

KNJF-01/2022

RREGULLORE (KNJF) 01/2022

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS NGA ORGANIZATAT JOQEVERITARE PËRMES PARTNERITETIT ME AGJENCINË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS NË KOSOVË

Në pajtim me nenin 30 të Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas (Gazeta Zyrtare, Nr. 03, 22 shkurt 2022) dhe në pajtim me nenin 18, të Rregullores Nr.01/2021, për Punën e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, Këshilli për Ndihmë Juridike Falas, nxjerrë këtë:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS NGA ORGANIZATAT JOQEVERITARE PËRMES PARTNERITETIT ME AGJENCINË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i kritereve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga organizatat joqeveritare.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për OJQ-të, te cilat ofrojnë ndihmë juridike falas në Republikën e Kosovës përmes partneritetit me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në vijim, kanë kuptimin e njëjtë sikur në Ligjin përkatës për Ndihmë Juridike Falas dhe në Ligjin përkatës për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare:

   1.1. **Agjencia** – nënkupton Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas që është institucion i pavarur publik dhe institucion i vetëm në territorin e Republikës së Kosovës përgjegjës për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas.

   1.2. **Këshilli** - nënkupton Këshillin për Ndihmë Juridike Falas që është institucion themelor i cili kryen funksionet në mënyrë të pavarur nga institucionet e tjera publike, pa udhëzime dhe ndërhyrje nga asnjë person, si dhe ushtron mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Agjencisë, në pajtim me ligjin përkatës për ndihmë juridike falas.

1.3. **Ndihma Juridike Falas** – është e drejtë në shërbime profesionale juridike falas për qytetarët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për Ndihmë Juridike Falas.

1.4. **Organizatë Joqeveritare (OJQ) vendore** – është person juridik i pavarur dhe jo për përfitim, i themeluar për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose interes të ndërsjellë e themeluar në Kosovë në pajtim me ligjin përkatës për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare;

1.5. **Partneriteti** – nënkupton formën e bashkëpunimit të krijuar përmes marrëveshjes së partneritetit midis Agjencisë dhe një apo më shumë organizatave joqeveritare;

1.6. **OJQ në partneritet** – është organizatë joqeveritare që hynë në partneritet me Agjencinë, përmes Marrëveshjes së Partneritetit;

1.7. **Regjistër i OJQ-ve** – është regjistri në të cilin janë të regjistruara të gjitha OJQ-të, ofruese të ndihmës juridike falas;

1.8. **Shërbimet e Autorizuara** – janë shërbimet që ofrohen në kuadër të ndihmës juridike primare dhe sekondare;

1.9. **Ndihma juridike primare** - përfshin, informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore; përpilimin e shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës; përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse; mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale; informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat kundërvajtëse; si dhe, informatat, këshillat juridike dhe ndihma në procedurat e ndërmjetësimit, arbitrazhit ashtu siç është paraparë me legjislacionin në fuqi;

1.10. **Ndihma juridike sekondare** – nënkupton, shërbimin e përpilimit të shkresave dhe tërë ndihmën tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës, si edhe përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse;

1.11. **Fushat prioritare** – janë fushat e identifikuara me prioritet dhe niveli i rëndësisë se ofrimin e ndihmës juridike falas.

Neni 4

Marrëveshja për Partneritet

1. OJQ-ja që dëshiron të ofrojë shërbime të ndihmë juridike falas, duhet të lidhë Marrëveshje për Partneritetit me Agjencinë, sipas kritereve të përcaktuara me këtë Rregullore.
2. Marrëveshja për partneritet bëhet në formë të shkruar dhe lidhet për kohë të pakufizuar.

3. Marrëveshja për partneritet duhet të përcaktoj:

3.1. Shërbimet e ndihmës juridike falas që do të ofrohen nga OJQ-ja;
3.2. Kategoritë e subjekteve përfituese të shërbimeve të ndihmës juridike falas që do të ofrohen nga OJQ-ja;
3.3. Territorin në të cilin do të ofrohen shërbimet e ndihmës juridike falas;
3.4. Çështje të tjera në zbatim të marrëveshjes për partneritet.

Neni 5

Kriteret e përgjithshme

1. OJQ-ja që ofron shërbime të ndihmës juridike falas mbi bazën e marrëveshjes për partneritet, duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme:

1.1 Të jetë organizatë joqeveritare e regjistruar në Republikën e Kosovës;
1.2 Te jetë OJQ me veprimtari të përqendruar në ndihmën juridike falas.
1.3 Të ketë në fushe veprimtarinë e saj ofrimin e ndihmës juridike falas;
1.4 Të ketë strukturë organizative të përcaktuar me aktet e brendshme të organizatës;
1.5 Të mos ketë shkelur kushtet e parashikuara të përdorimit të fondeve publike;
1.6 Të marr pjesë në programet për ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të ndihmës juridike falas.

Neni 6

Kriteret e posaçme

1. OJQ-ja që dëshiron të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas mbi bazën e marrëveshjes për partneritet, duhet të plotësojë këto kritere të posaçme:

1.1. Të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas në bazë të kritereve të përcaktuara në ligjin përkatës për ndihmë juridike falas;

1.2. Të parashohë në Statutin e saj se do të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas;

1.3. Të ketë në kuadër të saj një anëtar të personelit me provim të dhënë të jurisprudencës.

Neni 7

Hyrja në Partneritet

1. OJQ që i plotëson kriteret nga neni 5 dhe 6 i kësaj Rregulloreje, mund t'i parashtrojë Agjencisë në çdo kohë kërkesë për lidhjen e marrëveshjes për partneritet.
2. Drejtori i Agjencisë e shqyrton kërkesën për lidhjen e marrëveshjes për partneritet, brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi.
3. Pas shqyrtimit sipas paragrafit 2 të këtij neni, Drejtori i Agjencisë i propozon Këshillit refuzimin apo aprovimin e kërkesës për lidhjen e marrëveshjes për partneritet.
4. Këshilli vendosë për lidhjen e marrëveshjes për partneritet me shumicë të thjeshtë të votave.
5. Drejtori i Agjencisë e nënshkruan Marrëveshjen për Partneritet bazuar në autorizimin nga Këshilli.
6. Agjencia emëron zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e marrëveshjes së caktuar të partneritetit me OJQ, sipas procedurave në zbatim.

Neni 8

Regjistri i OJQ-ve ofruese të ndihmës juridike falas

1. Agjencia e krijon Regjistrin për OJQ-vetë ofruese të ndihmës juridike falas dhe e përditëson atë sipas nevojës dhe me rastin e lidhjes apo ndërprerjes së marrëveshjeve për partneritet. me të cilat hynë në partneritet.
2. Agjencia e bën përditësimin e Regjistrit, sipas nevojës dhe me rastin e lidhjes apo ndërprerjes se Marrëveshjes së Partneritetit.
3. Regjistri i OJQ-ve publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

Neni 9
Shkëmbimi i të dhënave

1. Për qëllime të organizmit, Agjencia dhe OJQ-të shkëmbejnë të dhëna të përgjithshme statistikore.
2. OJQ-ja i ofron informata Agjencisë bazuar në kriteret e përcaktuara në dispozitat e Marrëveshjes së Partneritetit.
3. Agjencia i ofron OJQ-së partnere qasje në të dhënat relevante, sipas dispozitave në fuqi dhe sipas kërkesës së OJQ-së.
4. Të dhënat statistikore të OJQ-së përfshihen në bazën e të dhënave të Agjencisë, sipas qasjes së lejuar në përputhje me ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 10

Ndërprerja e partneritetit

1. Agjencia mund të zgjidhë marrëveshjen për partneritet në rastet kur:

   1.1. OJQ-ja shuhet;
   1.2. Sipas Statutit të saj, OJQ-ja nuk ofron më shërbime të ndihmës juridike falas;
   1.3. OJQ-ja nuk i përmbahet kushteve për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas, të përcaktuara në marrëveshjen për partneritet, këtë Rregullore dhe në ligjin përkatës për ndihmë juridike falas;
   1.4. Për shkaqe tjera të përcaktuara në Ligjin Për Lirinë e Asocimit në OJQ.

Neni 11

Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja nr.2013/5 për përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga OJQ-të, në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit për Ndihmën Juridike Falas.

Kryesuese e Këshillit _____

Prishtinë, me 20 shtator 2022